



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit  
P-96  
Prishtinë, më 16 mars 2010, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 16 MARS 2010

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Slobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica,

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha dhe Sherif Konjufca,

Nga ICO: Blerta Bejtullahu,  
Nga OSBE: Floriana Shala,  
Nga NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtura më 9 mars 2010,
2. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit kundër procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit, për seancë të jashtëzakonshme,
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës, si dhe të Rekomandimit të komisionit funksional,
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit të Ujësjiellit dhe të Mbeturinave, si dhe të Rekomandimit të komisionit funksional,
5. Shqyrtimi i mocionit të deputetit Riza Smaka për përgatitjen e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijëve dhe të të miturve nga përmbajtjet dhe mesazhet e dëmshme programore,
6. Shqyrtimi i Mocionit të deputetit Driton Tali dhe të grupit të deputetëve për debat parlamentar rreth gjendjes në ndërmarrjet publike qendrore,
7. Shqyrtimi i Mocionit të deputetes Mimoza Ahmetaj dhe të grupit të deputetëve për procedim të Programit për barazi gjinore.

### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtura më 9 mars 2010**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtura më 9 mars 2010, u miratuan pa vërejtje.

### **2. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit kundër procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit, për seancë të jashtëzakonshme**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohen Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta shqyrtojnë kërkesën e Këshillit kundër procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit dhe Kuvendit t'ia paraqesin Raportin me rekomandime.

**3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës, si dhe të Rekomandimit të komisionit funksional**

Kryesia vendosi që Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës të radhitet për shqyrtim në rend dite të seancës tjetër të radhës.

**4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit të Ujësjetës dhe të Mbeturinave, si dhe të Rekomandimit të komisionit funksional**

Kryesia, pasi shqyrtoi Propozim-vendimin e cekur më lart, nxori këtë:

**P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit të Ujësjetës dhe të Mbeturinave dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

**5. Shqyrtimi i Mocionit të deputetit Riza Smaka për përgatitjen e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijëve dhe të të miturve nga përmbajtjet dhe mesazhet e dëmshme programore**

Kryesia, pasi shqyrtoi Mocionin e cekur më lart, nxori këtë

**P Ë R F U N D I M**

Kërkohe nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të japë mendimin lidhur me Mocionin e deputetit Riza Smaka lidhur me hartimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijëve dhe të të miturve nga përmbajtjet dhe mesazhet e dëmshme programore.

**6. Shqyrtimi i Mocionit të deputetit Driton Tali dhe të grupit të deputetëve për debat parlamentar rreth gjendjes në ndërmarrjet publike qendrore**

Kryesia, pasi shqyrtoi Mocionin e cekur më lart, nxori këtë:

**P Ë R F U N D I M**

Kërkoheh nga Qeveria e Republikës së Kosovës që t'ia paraqesë Kuvendit një Informatë të përgjithshme lidhur me gjendjen në ndërmarrjet publike qendrore, para privatizimit të ndërmarrjeve të parapara nga Qeveria.

**7. Shqyrtimi i Mocionit të deputetes Mimoza Ahmetaj dhe të grupit të deputetëve për procedim të Programit për barazi gjinore**

Kryesia, pasi shqyrtoi Mocionin e cekur më lart, nxori këtë:

**P Ë R F U N D I M**

Kërkoheh nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojë Programin e Qeverisë për barazi gjinore sa më shpejt që të jetë e mundshme dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

Procesverbalin hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**